

Vendim nr. 155 datë 07.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 07.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “AV GAS DISTRIBUTION” SH.A.,
SHOQËRIA “INTER GAZ” SH.A.,
SHOQËRIA “AV INTERNATIONAL GROUP”
SH.A.**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1430, datë 18.01.2023
të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm
me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës ka rezultuar se midis shtetasve J.M. dhe P.B., ky i fundit në cilësinë e aksionerit maxhoritar të shoqërisë “Inter Gaz” sh.a., si dhe shoqërive “A&V Gas” sh.a., “AV Gas Distribution” sh.a., është lidhur një marrëveshje noteriale me nr. 8822 rep., nr. 1890 kol., datë 15.12.2009, sipas së cilës palët kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në biznes për import-eksportin dhe tregtimin e gazit të lëngshëm, deri në një kohë të pacaktuar ose deri në një marrëveshje të dytë. Nga fitimi që do të realizohej nga ky aktivitet, shtetasi J.M. do të përfitonte 1/3-n e fitimit të plotë. Gjatë periudhës kohore nëntor 2008-qershor 2009, aktiviteti i tregtimit të gazit është e zhvilluar edhe me dy kërkuueset e tjera, shoqëritë “A&V-GAS” sh.a. dhe “AV GAS Distribution” sh.a.

2. Shtetasi J.M. ka pretenduar se të tria shoqëritë kanë paguar një pjesë të fitimit, por nuk kanë paguar fitimin e plotë që është realizuar nga ky aktivitet. Sipas dispozitave që përcaktohen në Kodin Civil, që rregullojnë marrëveshjen e shoqërisë së thjeshtë, ai ka pretenduar se shoqëritë ishin të detyruara ta njoftonin atë për ecurinë e punëve në pjesën e aktivitetit të tregtimit të gazit të lëngshëm dhe t’i vinin në dispozicion dokumentet që lidheshin me punën e kryer dhe me fitimin e realizuar. Për këtë arsye, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padi me objekt detyrimin e shoqërive për të vënë në dispozicion raportin për punët e kryera dhe fitimin e realizuar nga zhvillimi i aktivitetit tregtar në zbatim të marrëveshjes së datës 15.12.2009.

3. Në funksion të zgjidhjes së çështjes, shtetasi J.M. (paditës në gjykim) ka kërkuar kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka pranuar kërkesën për kryerjen e aktit të ekspertimit dhe ka vendosur që shpenzimet për aktin e ekspertimit të paguheshin nga ai, si palë paditëse në atë gjykim.

4. Në seancën e datës 16.07.2018, J.M. ka refuzuar të paguajë detyrimin për aktin e ekspertimit, megjithëse gjykata e rrethit në seancën paraardhëse kishte vendosur që detyrimi të ulej dhe njëkohësisht të përpjesëtohej në mënyrë të barabartë për palët. Po gjatë kësaj seance shtetasi J.M. ka kërkuar të përjashtohet nga taksat dhe tarifat gjyqësore, me argumentin se ndodhej në pamundësi objektive dhe se ligji e parashikon si mundësi për t’u përjashtuar nga pagesa për shpenzimet e ekspertit, si dhe për shumën 1% të vlerës së padisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e ndodhur përpara këtij pretendimi, ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore

për t'i dhënë mundësi paditësit J.M. të paguajë detyrimet. Në seancën vijuese shtetasi J.M. ka përsëritur të njëjtën kërkesë për përjashtimin nga detyrimet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur refuzimin e kërkesës për përjashtimin nga taksat dhe tarifat gjyqësore.

5. Në seancën e datës 25.09.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka verifikuar se përsëri nuk ishin paguar detyrimet për aktin e ekspertimit, si dhe shuma 1 % e vlerës së padisë, me vendimin nr. (11-2018-4604) 1428, datë 25.09.2018, ka vendosur kthimin e padisë dhe të akteve bashkëlidhur, për mospagimin të 1% të vlerës së padisë dhe për mosshlyerjen e detyrimeve për kryerjen e aktit të ekspertimit.

6. Nga përmbajtja e historikut të ekstraktit për të dhënat e shoqërisë “A&V Gaz” sh.a., ka rezultuar se me vendimin nr. 8, datë 12.10.2018 të aksionarit të vetëm të kësaj shoqërie P.B., është vendosur ndryshimi i emrit tregtar të kësaj shoqërie, i cili është caktuar të jetë “AV International Group” sh.a. Për këtë shkak, te aktet pas kësaj date është përdorur emri i ri tregtar i shoqërisë.

7. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kanë paraqitur ankim shtetasi J.M., i cili ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit, shtetasi P.B., i cili ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit, si dhe kërkeset, që kanë kërkuar ndryshimin e vendimit, si dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2019-596 (209), datë 03.04.2019, ka vendosur prishjen e vendimit nr. (11-2018-4604) 1428, datë 25.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

8. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës kanë ushtruar rekurs kërkeset, si dhe kundërrekurs shtetasi J.M. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2023-1430, datë 18.01.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10-2019-596 (209), datë 03.04.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.

9. Kërkeset në datën 18.05.2023 (data e shërbimit postar) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1430, datë 18.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili është regjistruar përfundimisht në datën 07.06.2023.

II

Pretendimet e kërkueseve

10. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se:

10.1. *Është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:*

10.1.1. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është jologjik dhe kontradiktor. Gjykata e Apelit Durrës e ka konsideruar të gabuar përfundimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për kthimin e padisë me të meta gjatë gjykimit, veprim që duhej të ishte bërë në seancën përgatitore, por në dispozitiv ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe vazhdimin e gjykimit po në atë gjykatë. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Durrës nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve.

10.2. Paditësi J.M. ka abuzuar me të drejtën, duke kërkuar përjashtimin nga pagesa e detyrimeve. Vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është e drejtë dhe ka siguruar një baraspeshë mes interesit të shtetit në mbledhjen e taksave gjyqësore dhe interesit të kërkuarit, duke mos e cenuar të drejtën e aksesit.

10.3. Gjykata e Lartë, duke lënë fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, ka cenuar *parimin e proporcionalitetit* në lidhje me pagimin e shpenzimeve gjyqësore, duke vendosur një praktikë diskriminuese për subjektet që paguajnë taksën e padisë, si kusht formal për pranueshmërinë e padisë për gjykim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individit, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në

lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

13. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimitimi i kërkueseve, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuëset, legjitimohen në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse janë palë të paditura në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuuesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron ajo, përfshirë edhe rastet e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të

njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata zhvillon gjykimin përfundimtar të ankesave të individit, që nënkupton se çdo individ legjitimohet në ankimin kushtetues individual kundër një vendimi gjyqësor, me kusht që procesi gjyqësor i shqyrtimit të themelit të çështjes të jetë përfunduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet kur mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkueset i janë drejtuar Gjykatës, duke parashtruar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, që ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka dërguar çështjen për vazhdimin e gjyimit po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, është jologjik dhe kontradiktor. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka cenuar parimin e proporcionalitetit për subjektet që paguajnë shpenzimet gjyqësore dhe paditësi J.M. ka abuzuar me të drejtën, duke kërkuar përjashtimin nga pagesa të këtyre detyrimeve.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, i cili përcakton natyrën “përfundimtare” të gjyimit kushtetues, si rregull, individ i mund t’i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë situatë, për të vlerësuar përmbushjen e kriterit të shterimit të

mjeteve juridike efektive, merr rëndësi të përcaktohet nëse vendimi i kundërshtuar nga kërkueset në ankimin e tyre ka formë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Objekti i ankimit kushtetues individual, në rastin konkret, lidhet me vendimin e Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, i cili ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka dërguar çështjen për vazhdimin e gjykimit po në atë gjykatë.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se meqenëse gjykimi i çështjes që u përket kërkueseve është ende në proces dhe i papërfunduar, për sa kohë që çështja është në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ato i kanë të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave pranë atyre gjykatave, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.